



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

AGJENCIA E PARQEVË DHE REKREACIONIT
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIT**

Drejtuar: Operatorit ekonomik “KASTRATI ENERGY” me **NIPT: J61813529P**

Adresa: DURRES Lagja 14, Rruga Tirana, Prane Gjykes se Apelit, Shkozet, Shqipëri

* * *

Tipi i Kontratës: **Kontratë mall**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë monetar, Marrëveshje
kuadër e ndarë në lote**

Numri i Procedurës /referenca e Lotit: **REF-91339-06-25-2026**

Loti 1: REF-91344-06-25-2026

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: **“Blerje Karburanti”**

LOTI 1: “Blerje gazoil deri në 10 ppm”

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **25.06.2026**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike **29 Qershor 2026,**
Buletini Nr. 41

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

LOTI 1: “Blerje gazoil deri në 10 ppm” Nr. REF-91344-06-25-2026

1. Operatori ekonomik “EUROPETROL DURRËS ALBANIA” NIPT: K24010212N

Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute: **10.99 Lek/Liter pa TVSH**

Vlera e ofertës: 26,906,690 (njëzet e gjashtë milion e nëtëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh,
pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor

2. Operatori ekonomik “KASTRATI ENERGY” NIPT: J61813529P

Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute: **19 Lek/Liter pa TVSH**

Vlera e ofertës: 26,906,690 (njëzet e gjashtë milion e nëtëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh,

.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor

**3. Operatori ekonomik BOE “A&T” NIPT: L32320008H pjesëmarrje në përqindje 60% dhe
“2A2F-L OIL” NIPT:L41915013M pjesëmarrje në përqindje 40%**

Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute: **23.50 Lek/Liter pa TVSH**

Vlera e ofertës: 26,906,690 (njëzet e gjashtë milion e nëtëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh,.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☒ JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat:

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “EUROPETROL DURRËS ALBANIA” NIPT: K24010212N

Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute: **10.99 Lek/Liter pa TVSH**

Vlera e ofertës: 26,906,690 (njëzet e gjashtë milion e nëtëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh,

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, dhe të Kreut X Nenit 82 pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi se:

- a. Në Kriteret e Veçanta për Kualifikim të përcaktuara në DST, konkretisht Kapaciteti Teknik pika 2.2.1, pika a. “... Licencë lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë;...” Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoritetit kontraktor, Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 (dy) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve që duhet të jenë brenda territorit të Bashkisë Tiranë, gjithashtu duhet të paraqesin Lisencën e lartpërmendur. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistem, rezulton se Operatori Ekonomik nuk e përmbush këtë kriter.
- b. Në Kriteret e Veçanta për Kualifikim të përcaktuara në DST, konkretisht Kapaciteti Teknik pika 2.2.2, “ Operatori Ekonomik duhet të sigurojë 1 (një) autobus jo më shumë se 1000 litra për arsye të furnizimit sipas nevojave të sektorëve të ndryshëm të Autoritetit Kontraktor...”, Kjo kërkesë specifike lidhur me Kapaciteti maksimal prej 1000 litrash është përcaktuar për shkak të kufizimeve të hapësirës dhe terrenit në zonën e aksesit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se Operatori Ekonomik disponon një autobus me kapacitet 2000L, gjithashtu në Formularin e Vetëdeklarimit nuk është specifikuar pajisja që do të vihet në dispozicion. Në këto kushte Operatori Ekonomik nuk e përmbush kriterin e sipërcituar.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatorit Ekonomik “**EUROPETROL DURRËS ALBANIA**” nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë të pavlefshme**.

2. Operatori ekonomik BOE “A&T” NIPT: L32320008H pjesëmarrje në përqindje 60% dhe “2A2F-L OIL” NIPT:L41915013M pjesëmarrje në përqindje 40%

Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute: **23.50 Lek/Liter pa TVSH**

Vlera e ofertës: 26,906,690 (njëzet e gjashtë milion e nëtëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO x JO ☐

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, dhe të Kreut X Nenit 82 pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi se:

- a. Në Kriteret e Veçanta për Kualifikim të përcaktuara në DST, konkretisht Kapaciteti Teknik pika 2.2.1, pika a. “... Licencë lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë;...” Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoritetit kontraktor, Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 (dy) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve që duhet të jenë brenda territorit të Bashkisë Tiranë, gjithashtu duhet të paraqesin Lisencën e lartpërmendur. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistem, rezulton se Operatori Ekonomik nuk e përmbush këtë kriter.
- b. Në Kriteret e Veçanta për Kualifikim të përcaktuara në DST, konkretisht Kapaciteti Teknik pika 2.2.4, pika b, “ISO 9001:2015 mbi ‘Sistemet e menaxhimit të cilësisë’ ose ekuivalente të tij me objekt aktiviteti...” Operatori Ekonomik 2A2F nuk e disponon këtë certifikim. Në këto kushte kriteri rezulton i papërmbushur.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatorët Ekonomikë **BOE “A&T” NIPT: L32320008H dhe “2A2F-L OIL” NIPT:L41915013M** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë të pavlefshme.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur **LOTI 1: “Blerje gazoil deri në 10 ppm” Nr. REF-91344-06-25-2026**, se oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “**KASTRATI ENERGY me NIPT: J61813529P**”, me normë fitimi të shprehur në vlerë absolute: **19 Lek/Liter pa TVSH**, Vlera e ofertës: **26,906,690 (njëzet e gjashtë milion e nëtëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh**, është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.